

**V E N D I M**  
**Nr.320, datë 30.6.1993**

**PËR KËSHILLIN KOMBËTAR TË KONTABILITETIT**

Në mbështetje të ligjit nr.7661, datë 19.1.1993 "Për kontabilitetin", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Pranë Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë krijohet Këshilli Kombëtar i Kontabiliteti i përbërë nga nëntë veta.

Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit caktohen nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë për një kohë prej 4 vjetësh. Ata mund të ricaktohen. Në ricaktimin e anëtarëve të këshillit mbahet parasysh si kontributi i çdo anëtari gjatë mandatit të mëparshëm, ashtu edhe nevoja e ripërtëritjes së këshillit.

Kryetari i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit zgjidhet nga anëtarët e këshillit me votim të lirë, për një kohë prej 4 vjetësh. Ai mund të rizgjidhet, por jo më shumë se dy herë radhazi.

Kryetari i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit cakton një nga anëtarët për ta zëvendësuar në mungesë të tij.

2. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit mbledhet në seanca plenare, sipas një kalendari të miratuar prej tij në fillim të çdo viti, si dhe sa herë që gjykohet e nevojshme nga kryetari i tij. Seancat drejtohen nga kryetari i këshillit dhe, në mungesë të tij, nga anëtari i caktuar për zëvendësim.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit merr vendime për çështje që shqyrton vetëm kur janë të pranishëm jo më pak se dy të tretat e anëtarëve. Vendimet merren me shumicë votash. Nëse votat janë të barabarta, ajo e kryetarit është përcaktuese.

Për kryerjen e detyrave të tij këshilli krijon seksione ose komisione të veçanta që kryesohen nga një anëtar i këshillit.

3. Ministri i Financave dhe i Ekonomisë, me nismën e vet ose me propozimin e kryetarit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, i heq të drejtën e anëtarësisë çdo anëtari të Këshillit, i cili pa arsye të përligjura:

- nuk pranon, heq dorë ose nuk përmbush detyrimet ndaj këshillit, apo nuk kryen punimet e veçanta që i janë ngarkuar;

- nuk merr pjesë në katër mbledhje të njëpasnjëshme të këshillit.

4. Anëtarët e këshillit kanë të drejtën e shpërblimit për kohën që shpenzojnë dhe punët që kryejnë për funksionimin dhe realizimin e detyrave të këshillit. Masa e shpërblimit caktohet çdo vit nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë, në varësi edhe nga të ardhurat e realizuara nga botimet e nga veprimtari të tjera të këshillit. Shpërblimi mesatar mujor caktohet nga 20 deri në 40 për qind të pagës së drejtorit të drejtorisë në ministri për anëtarët dhe nga 30 deri në 50 për qind për kryetarin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

5. Rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit përcaktohen në rregulloren e brendshme të tij, e cila miratohet nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**